



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Driton Hoxha" nr. 55, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 500 400, Fax: + 383 (0)38 248 076, e-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

Bazuar në paragrafin 1 të Nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, paragrafit 1 të Nenit 10 A të Rregullores (QRK) NR 05/2024 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores 15/2023, si dhe bazuar në paragrafin 6 të Nenit 47, dhe Nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarë Publik, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 22 Shtator 2025, publikon këtë:

NJOFTIM PËR ANULIM

Anulohet Konkursi me nr. reference RN00018306 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

ARSYETIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me datë 25 korrik, ka shpallur konkursin me nr. Reference RN00018306 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Me datë 08 shtator 2025, ka përfunduar faza e verifikimit paraprak, me ç'rast është publikuar lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, sipas konkursit.

Faza e radhës, respektivisht faza e vlerësimit profesional duhet të kryhet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kalojnë verifikimin paraprak. Faza e vlerësimit profesional kryhet nga komisioni i pranimi për pozita të nivelit të lartë drejtues, anëtarët e së cilit duhet të emërohen nga titullari i institucionit. Meqenëse AKP nuk ka titullar aktualisht, përderisa mandati i Bordit të Drejtorëve të AKP ka skaduar, komisioni në fjalë nuk mund të themelohet brenda afatit ligjor për konkursin RN00018306.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Prishtinë, 22 Shtator, 2025.



Ilir Meqa

Ilir Meqa
Udhëheqës i Burimeve Njerëzore
Agjencia Kosovare e Privatizimit